



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/377

Më:29/05/2017

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gzeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i punës zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Dëshmorët e fshatit" në Bubavec	Mësimdhënës/e fizikës	Zavendesim i pushimit mjekësor deri më 30.06.2017	1	20
2	SHFMU" Beqir Gashi" në Mleqan	Mësimdhënës/e muzikës	i lirë	1	18
3	SHFMU" Kajtaz Ramadani" paraleleja në Gulluboc dhe Stapanicë	Mësimdhënës/e matematikë	i lirë	1	20
4	SHFMU" Kajtaz Ramadani" paralelje në Gulluboc	Puntor teknik(pastrues)	i lirë	1	40
5	SHFMU" Nuhi Mazreku" në Guriç	Drejtor/esh	i lirë	1	40
6	SHFMU" Institucioni parashkollor Qerdhja e fëmijëve" zërat e Êmbël" në Malishevë	Drejtor/esh	i lirë	1	40

I. Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose çertifikatat), çertifikatat në vend të diplomes duhet të jenë të notorizuar të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktura me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të lëndës së fizikës**

- 1.Fakulteti i edukimit-programi Fizikë Kimi/Kimi -Fizikë;
- 2.Fakulteti i SHMN dega e fizikës arsimore:

❖ **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të edukatës muzikore**

- 1.Fakulteti i Arteve të bukura-dega e arteve muzikore;
- 2.Fakulteti i Filologjisë-dega e Gjuhës dhe letërsisë angleze

❖ **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të lëndës së matematikës**

- 1.Fakulteti i edukimit –progrmi Matematikë-informatikë;
- 2.FSHMN dega e matematikës arsimore.

❖ **Kriteret e kualifikimit për punëtor teknik (pastrues)**

- 1.Shkolla fillore

❖ **Kriteret e kualifikimit për drejtor shkolle**

Kualifikimet, shkathtësitë, aftësitë dhe përvoja:

- Kërkohe Kualifikimi i arsimit universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranushme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje,administrim ose menaxhim.
- Të ketë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente;

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Protofolion profesionale;
- Letërreferencë nga një institucion publik-kredibil (MASHT,DKAE,Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Plani zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuse për të cilin ka konkuruar(së paku 10 faqe tekst me hapsirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
- Njohuri në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve themelore të
- Microsoft Office (dëshmi nëse ka);

- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është nën hetime.

SQARIM:

- Në institucionet e arsimit fillor (1-5), kandidatët duhet të kenë së paku 240 ECTS, përkatësisht 4 vjet.
- Në institucionet e arsimit të mesëm të ulët (6-9), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ECTS, përkatësisht 5 vjet

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartëcekur, do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

Kandidatët me kualifikim jo përkatës dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UD nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të verteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Përsoneat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më:**29.05.2017 deri më datën 13.06.2017**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkura) duhet të dorëzohet përmes protokolit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.